



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

Nr. 3193 prot.

Tiranë, më 3 . 4 .2020

URDHËR

Nr. 91 , datë 3 . 4 .2020

Për

“Konfirmimin dhe vijimin e masave administrative të marra deri në përfundim të gjëndjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni Covid -19”.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 221, datë 23.03.2016 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ATP”; Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.156, datë 10.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” i ndryshuar me Urdhërin nr. 223, datë 01.04.2020; Vendim nr.1, datë 25.3.2020 “Për konfirmimin dhe vijimin e zbatimit të masave të veçanta administrative të marra gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 237 “Për një shtesë në vendimin nr.511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", të ndryshuar ; Vendim nr.208, datë 10.3.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e datave 10 deri 23 mars 2020 ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur”;;

URDHËROJ

1. Konfirmimin dhe vijimin e masave administrative të marra, deri në përfundim të gjëndjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni Covid -19, si më poshtë vijon:
 - a. Të gjithë punonjësit e Agjencisë së Trajtimit të pronave, do të vijojnë të punojnë pranë institucionit dhe/ose në distancë, sipas grafikëve të përcaktuar nga secila Drejtori.
 - b. Orari zyrtar i punës do të jetë 08:00-13.00, përveç nëpunësve pjesë e Task Forcës për përballimin situatës së krijuar nga virusi Covid-19 të cilëve mund t’iu kërkohet të punojnë

edhe jashtë këtij orari.

- c. Mbylljen e sporteve të marrëdhënieve me publikun për shërbime dhe aplikime deri në përfundim të gjendjes së epidemisë dhe vijimin e shërbimeve vetëm online dhe përmes postës zyrtare.
 - d. Vijimin ditë pushimi për njërin nga prindërit kujdestar që kanë fëmijë dhe frekuentojnë/ndjekin ose jo cerdhet, arsimin parashkollor dhe arsimin bazë
 - e. Punonjësit që do të punojnë në distancë, do t'iu delegohen shkresat nëpërmjet e-mailit zyrtarë nga eprorët përkatës. Nëpunësi që i është deleguar praktika do të shqyrtojë dhe hartojë përgjigjen dhe pas marrjes së miratimit nga eprori përkatës e dërgon atë tek nëpunësi që është ngarkuar të jetë prezent në institucioni sipas grafikut përkatës, për procesim të mëtejshëm.
 - f. Për shkak të numrit të reduktuar të punonjësve në institucione, delegimi i shkresave do të bëhet nëpërmjet sistemeve elektronike e – albania /SQDNE/e-aktet/e-mail zyrtarë dhe të njëjtën mënyrë do të procedohet dhe për kthimin e përgjigjeve, me përjashtim të rasteve të drejtorive specifike. Afatet për procesimin e shkresave janë të njëjta, si zakonisht dhe nuk do të tolerohet asnjë vonesë në kthimin e përgjigjeve.
 - g. Punonjësit që do të paraqiten në punë sipas grafikut të përcaktuar, duhet të respektojnë të gjitha udhëzimet e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për mbrojtjen personale dhe marrjen e masave mbrojtëse për mospërhapjen e virusit (të ruhet distanca 1.5 m nga njëri tjetri/përdorimi i maskave/ dorezave dhe dizinfektantëve).
2. Ky Urdhër zbatohet deri në një urdhër të dytë.
 3. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PERGJITHSHEM

Jonida Baci

